

*AGJENCIA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË*

# *Raporti vjetor*

## *2013*


07/4 3898
73 03.07.2014
PRISHTINË/A

## Përmbajtja

Shkurtesat ... 3
Lista e Tabelave ... 4
Lista e figurave ... 5
**Divizioni i Administratës së Përgjithshme** ... 6
Organizimi i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë ... 6
**Divizioni i Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural** ... 16
Masa 4 Investimet në Përpunim dhe Marketingun e Produkteve Bujqësore ... 19
Masa 4 Investimet në Përpunim dhe Marketingun e Produkteve Bujqësore / Ndërtimi i Depove ... 19
Masa 8 Përkrahje për zhvillimin e komunitetit lokal ... 19
Zona më pak të favorizuar ( Pilot Masa) ... 19
Totali i aplikuesve dhe vlera e aplikuar per PZHR ... 19
Vështirësitë e hasura gjatë Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural ... 23
**Divizioni i Autorizimit të Pagesave** ... 24
**Divizioni i Pagesave Direkte** ... 31
Mbjellje vjeshtore– Grurë ... 31
Farë Gruri ... 34
Misër ... 35
Luledielli ... 37
Lope Qumështore ... 37
Dele dhe Dhi ... 40
Bletë ... 44
Material Fidanor ... 47
Shpezëtari ... 48
Përmbledhje e Pagesave Direkte ... 49
**Divizioni i Kontrollit në terren** ... 51
Kontrolli në terren- Pagesa Direkte ... 52
Kontrolli në terren për Masat e Zhvillimit Rural ... 55
**Divizioni i IT & Regjistrave** ... 60
Fotografi tek Projektet e Zhvillimit Rural ... 69

# Shkurtesat

AZHB – Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë

MBPZHR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

AM - Autoriteti Menaxhues

BB – Banka Botërore

DAP – Departamenti i Administrates së Përgjithshme

sLPIS – Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës

MF SIMFK – Ministria e Financave Sistemi i Menaxhimit të Financave Kosovë

APK – Agjencia e Pyjeve të Kosoves

AUK – Agjencia e Ushqimit të Kosovës

U/A – Udhëzues Administrativ

KEP – Institucion Mikrofinancar

PTK – Posta dhe Telekomi i Kosovës

PD – Pagesa Direkte

PZHR – Projektet e Zhvillimit Rural

eFR – Regjistri Elektronik i Fermerëve

# Lista e Tabelave

Tabela 1. *Struktura e të punësuarve sipas përgatitjes profesionale ne AZHB*
Tabela 4. *Raporti i shpenzimeve të automjeteve, janar – dhjetor 2013*
Tabela 5. *Realizueshmëria e Projekteve të Zhvillim Rural*
Tabela 6. *Buxheti për projektet e zhvillimit rural sipas Masave*
Tabela 7. *Numri i aplikuesve për Projektet e Zhvillimit Rural*
Tabela 8. *Buxhet nacional për vitin 2013*
Tabela 9. *Buxheti i Bankës Botërore për vitin 2013*
Tabela 10. *Buxhet nacional për vitin 2014*
Tabela 11. *Buxheti i Danidës për vitin 2014*
Tabela 12. *Buxhet nacional për vitin 2013*
Tabela 13. *Shuma totale e buxhetit për projektet e zhvillimit rural për vitin 2013*
Tabela 14. *Paraqitja tabelore e numrit të përfituesve për projektet e Zhvillimit Rural*
Tabela 2. *Numri i të refuzuarve sipas masave*
Tabela 16. *Fermerët përfitues dhe të refuzuar sipas komunave për Pagesa Direkte- Grurë*
Tabela 17. *Përfituesit dhe sipërfaqja e subvencionuar për prodhuesit e farës së grurit sipas komunave*
Tabela 18. *Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar - misër sipas komunave*
Tabela 19. *Numri i fermerëve përfitues dhe sipërfaqja e subvencionuar për luledielli sipas komunave*
Tabela 20. *Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe numri i krerëve te subvencionuar për lopë qumështore sipas komunave.*
Tabela 21. *Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve, dhe numri i krerëve të subvencionuar për dele sipas komunave*
Tabela 22. *Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve, dhe numri i krerëve të subvencionuar për dhi sipas komunave.*
Tabela 23. *Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe numri i koshereve të subvencionuara për bletë sipas komunave*
Tabela 24. *Numri i aplikuesve përfituesve, të refuzuarve dhe numri i fidanëve të subvencionuar sipas komunave*
Tabela 25. *Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe numri i sipërfaqeve te vreshtave të subvencionuar sipas komunave*
Tabela 26. *Totali i pagesave për vitin 2013.*
Tabela 27.Numri *i Kontrolleve të Realizuara për Pagesa Direkte - 2013*
Tabela 28. *Numri i kontrolleve të realizuara sipas Nën-masave*
Tabela 29. *Totali i kontrolleve të realizuara në vitin 2013*

## Lista e figurave

Figura 1. *Numri i përgjithshëm i ankesave për PD dhe PZHR*
Figura 2. *Organogrami i AZHB-së*
Figura 3. *Paraqitja grafike e strukturës së të punësuarve sipas përgatitjes profesionale ne AZHB*
Figura 4. *Shpenzimet e karburanteve për vitin 2013*
Figura 5. *Numri i kilometrave të kaluar për veturat e AZHB-së*
Figura 7. *Numri i shqyrtimit të ankesave për pagesa direkte*
Figura 8. *Numri i ankesave pashqyrtuara për PZHR*
Figura 9. *Krahasimi i numrit të aplikuesve për PZHR 2010-2013*
Figura 10. *Vlera e aplikuar në tabelën e mësipërme për vitin 2013 është paraqitur vetëm përkrahja publike*
Figura 11. *Paraqitja grafike e numrit të përfituesve të financuar nga Banka Botërore për vitin 2013*
Figura 12. *Paraqitja grafike e numrit të përfituesve nga buxheti i përgjithshëm*
Figura 13. *Paraqitja grafike e buxhetit të Danidës për vitin 2014*
Figure 14. *Paraqitja grafike e Pagesat sipas buxheteve*
Figura 15. *Paraqitja grafike e numrit të përfituesve të projekteve të Zhvillimit Rural*
Figura 16. *Krahasimi i shumës së pagesave për vitin 2011, 2012, 2013*
Figura 17. *Krahasimi i shumës së pagesës për fare gruri për vitin 2012 dhe 2013*
Figura 18. *Krahasimi i shumës se pagesave për misër për vitin 2012 dhe 2013*
Figura 19. *Përqindja e përfituesve sipas regjioneve*
Figura 20. *Krahasimi i numrit të aplikuesve dhe numrit të përfituesve*
Figura 21. *Numri i përfituesve të subvencioneve për dele sipas regjioneve*
Figure 22. *Krahasimi i numrit të aplikuesve dhe numrit të përfituesve*
Figura 23. *Numri i përfituesve të subvencioneve për dhi sipas regjioneve*
Figura 24. *Krahasimi i numrit të aplikuesve dhe numrit të përfituesve*
Figura 25. *Numri i përfituesve të subvencioneve për bletë sipas regjioneve*
Figura 26. *Krahasimi i numrit të aplikuesve dhe numrit të përfituesve*
Figura 27. *Numri i përfituesve të materialit fidanor sipas komunave*
Figura 28. *Numri i përfituesve të subvencioneve për shpezë sipas regjioneve*
Figura 29. *Paraqitja grafike e shumës së Pagesave Direkte për vitet 2010, 2011, 2012 dhe 2013*
Figura 30. *Numri i aplikuesve si dhe Kontrollet e realizuara për Pagesa Direkte 2013*
Figura 31. *Kontrollat në terren për Projektet e Zhvillimit Rural*
Figura 32. *Totali i kontrolleve të realizuara në vitin 2013*
Figura 33. *Softueri për indikator*
Figure 34. *Softueri sLIPS Mobile*
Figura 35. *Regjistri Elektronik i Fermerëve*
Figura 36. *Regjistri Elektronik i Fermerëve*
Figura 37. *Sistemin e Thjeshtësuar te Identifikimit të Parcelave të Tokës*
Figura 38. *Diagrami i sipërfaqeve të digjitalizuara dhe numrit të parcelave sipas vitit 2012 dhe 2013*
Figura 39. *Softuerin për Menaxhimin e Pagesave*
Figura 40. *Skema e IT-së, AZHB – MAP*
Figura 41. *Skema e regjistrrave dhe stastikave, AZHB – MBPZHR – AUV*

# Divizioni i Administratës së Përgjithshme

## Organizimi i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë është themeluar me Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural nr. 04/L-090 për ndryshim plotësimin e Ligjit me nr. 03/L-98 si Agjenci Ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Bazuar në ligj dhe në rregulloren nr. 01/2012 për Detyrat, Përgjegjësitë, Kompetencat dhe Strukturën Organizative, Agjencisë i përcaktohet roli si Agjenci Ekzekutive e cila merret me implementimin e programeve për mbështetje në bujqësi dhe zhvillim rural.

Në agjenci gjatë vitit 2013 kanë qenë funksionale pesë Divizione me përgjegjësi të përcaktuara sipas rregullores të cilat do të shndërrohen në drejtori gjatë fillim të vitit 2014. Gjatë këtij viti nuk është themeluar Divizioni- Drejtorati i Autorizimit të Pagesave si dhe Drejtorati për Financa që do të funksionalizohen në fillim te vitit 2014. Në këto Divizione kanë qenë të punësuar 63 punëtor prej tyre 32 me kontrata të rregullta, 18 me kontrata me BB dhe 13 me kontrata për shërbime të veçanta.

# Organogrami i AZHB-së

Figura 2. *Organogrami i AZHB-së*



Tabela 3. *Struktura e të punësuarve sipas përgatitjes profesionale ne AZHB*

| Përgatitja Profesionale | Numri i të punësuarve | Pjesëmarrja në % |
|---|---|---|
| **Agronom** | 40 | 64.51 |
| **Ekonomist** | 13 | 20.96 |
| **Jurist** | 4 | 6.45 |
| **Veteriner** | 1 | 1.61 |
| **Ekonomist /TI** | 1 | 1.61 |
| **Gjeograf/TI** | 1 | 1.61 |
| **Kimi -Teknologji** | 1 | 1.61 |
| **Shkenca Kompjuterike/TI** | 1 | 1.61 |
| **Gjithsej** | **62** | **100.00** |




Figura 3. *Paraqitja grafike e strukturës së të punësuarve sipas përgatitjes profesionale ne AZHB*

Gjatë vitit 2013 në AZHB janë zhvilluar aktivitetet e planifikuara konform rregullores për detyrat dhe përgjegjësitë duke pasur kujdes që gjatë implementimit të ketë kontroll të brendshëm gjatë kontrollit administrativ dhe kontrollit në teren. Edhe gjatë këtij viti kemi pasur ndarje të detyrave për t'i ikur konfliktit të interesit si dhe zbatimin e parimeve të kontrollit në katër sy.

Ndarja e detyrave sipas procedurave është realizuar duke ndarë procesin e aplikimit nga procesi i kontrollit administrativ dhe kontrollin në vend ngjarje. Edhe gjatë vitit 2013 procesi i aplikimit është zhvilluar në Drejtoritë Komunale për Bujqësi kurse proceset tjera në AZHB, kurse gjatë vitit 2014 ky proces për PZHR do të bartet në Zyrat Regjionale të AZHB-së për të shmang disa probleme të evidentuara.

**Trajnimet :** DAP ne bashkëpunim me divizionet tjera të AZHB-së gjatë v. 2013 ka organizuar trajnime të ndryshme për stafin e AZHB dhe stafin e Drejtorive Komunale:

- Trajnimi i stafit Komunal lidhur me programin dhe procedurat e aplikimit për grante dhe subvencione,
- Trajnimi i inspektoratit për procedurat e inspektimit për Pagesa Direkte,
- Trajnimi i inspektoratit për procedurat e inspektimit të Projektet e Zhvillimit Rural,
- Trajnimi i inspektoratit për përdorimin e sLPIS-it në vend ngjarje,
- Trajnimi i stafit të AZHB-së për kriteret, procedurat e akreditimit,
- Kursi i gjuhës angleze,
- Trajnimi i stafit për përdorimin e programit të MF SIMFK dhe
- Trajnime tjera nga fusha e TI, përdorimi i programeve kompjuterike, hartimit të planeve të biznesit, procedurave administrative etj.

Divizioni i Administratës së Përgjithshme gjatë viti 2013 ka realizuar detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara sipas rregullores nr 01/2012 në të gjithë Sektorët që kanë qenë funksional si sektori i logjistikës, sektori juridik dhe arkiva, nuk janë zhvilluar aktivitete në sektorin e prokurimit për shkak se ky sektor nuk është themeluar ende në AZHB.

**Logjistika:** Janë menaxhuar të gjitha automjetet zyrtare të AZHB-së dhe ato të huazuara nga institucionet tjera ( Komunave, APK dhe AUK ) në rastet kur AZHB-ja ka pasur volum të madh të punëve e mungesë të automjeteve. Viti 2013 karakterizohet me mungesë të automjeteve në periudha të ndryshme si dhe me probleme të theksuara gjatë servisimit. Gjatë këtij viti sipas raportit të shpenzimeve të derivateve janë shpenzuar 43,446 litra karburante dhe janë kaluar 425,918 km kryesisht për kontroll në vend të ngjarjes. Është pranuar dhe shpërndarë material shpenzues për zyrë, si tonerë, regjistratorë, letër për fotokopje dhe material tjetër, sipas kërkesave të zyrtarëve.

## Raporti i shpenzimeve të automjeteve, janar-dhjetor 2013

| Nr | Lloji i automjetit | Targat | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nentor | Dhjetor | TOTALI | Km | lit/100km |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Nissan | 3Z-101-16 | 132 | 61 | 170 | 29 | 260 | 195 | 316 | 239 | 245 | 467 | 248 | 257 | 2619 | 25775 | 10.16100873 |
| 2 | Hyundai | 3Z-003-16 | | | | | | | | | | 112 | | | 112 | 565 | 19.82300885 |
| 3 | Opel Astra | 3Z-010-16 | | | | 138 | | | | | | | | | 138 | 2425 | 5.690721649 |
| 4 | Kia Sportage | 3Z-105-16 | | | | | | | | | 108 | 43 | | | 151 | 1668 | 9.052757794 |
| 5 | Kia Sportage | 3Z-106-16 | 90 | 151 | 199 | 304 | 172 | | | | | | | , | 916 | 9627 | 9.514905994 |
| 6 | Toyota L.C. | 3Z-111-16 | 295 | 359 | 495 | 400 | 405 | 420 | 178 | | | | | | 2552 | 20412 | 12.50244954 |
| 7 | Shkoda Fabia | 3Z-113-16 | | | | | 109 | 155 | 184 | 179 | 221 | 220 | 77 | 89 | 1234 | 19820 | 6.226034309 |
| 8 | Suzuki | 3Z-120-16 | 106 | 154 | 225 | 187 | 172 | 242 | 50 | | | | | | 1136 | 13564 | 8.375111 |
| 9 | Suzuki | 3Z-123-16 | | 30 | 242 | 277 | 261 | 140 | 239 | 279 | 208 | 125 | 103 | 205 | 2109 | 21756 | 9.693877551 |
| 10 | Toyota L.C. | 3Z-124-16 | 254 | 177 | 263 | 328 | 230 | 420 | 368 | 376 | 327 | 155 | 234 | 310 | 3442 | 26386 | 13.044796 |
| 11 | Nissan | 3Z-133-16 | | | | | | | | | 168 | 489 | 186 | 312 | 1155 | 10642 | 10.853223 |
| 12 | Land Rover | 3Z-134-16 | | | | 212 | 223 | 130 | | | | | | | 565 | 5456 | 10.35557185 |
| 13 | Toyota L.C. | 3Z-138-16 | | | 241 | 314 | 350 | 392 | 420 | 439 | 374 | | 198 | 108 | 2530 | 20875 | 12.119760 |
| 14 | Nissan | 3Z-139-16 | | | 184 | 199 | 320 | 328 | 379 | 312 | 318 | 303 | 64 | 253 | 2660 | 25389 | 10.476978 |
| 15 | Nissan | 3Z-141-16 | 153 | 185 | 143 | | | | | | | | | | 481 | 4739 | 10.14982064 |
| 16 | Toyota L.C. | 3Z-142-16 | 352 | 192 | 325 | 344 | 327 | 369 | | | | | | | 1909 | 13638 | 13.99765361 |
| 17 | Nissan | 3Z-143-16 | 152 | | | | | | | | | 156 | | | 308 | 3618 | 8.512990603 |
| 18 | Galoper | 3Z-146-16 | 70 | 159 | 284 | 262 | 333 | 273 | 218 | 349 | 413 | 416 | 130 | 55 | 2962 | 28724 | 10.31193427 |
| 19 | Kia Sorento | 3Z-166-16 | | | | | | 239 | 415 | 305 | 311 | 518 | 285 | 316 | 2389 | 23080 | 10.35095321 |
| 20 | Kia Sorento | 3Z-167-16 | | | | | | 190 | 286 | 284 | 257 | 327 | 205 | 166 | 1715 | 22201 | 7.724877258 |
| 21 | Kia Sorento | 3Z-168-16 | | | | | | 226 | 268 | 312 | 221 | 276 | 319 | 281 | 1903 | 21715 | 8.763527516 |
| 22 | Kia Sorento | 3Z-169-16 | | | | | | 164 | 298 | 233 | 275 | 354 | 184 | 341 | 1849 | 19441 | 9.510827632 |
| 23 | Kia Sorento | 3Z-170-16 | | | | | | 243 | 292 | 293 | 300 | 438 | 315 | 321 | 2202 | 23396 | 9.411865276 |
| 24 | Kia Sorento | 3Z-171-16 | | | | | | 279 | 264 | 279 | 326 | 389 | 265 | 325 | 2127 | 23845 | 8.920109038 |
| 25 | Kia Sorento | 3Z-172-16 | | | | | | 58 | 195 | 202 | 112 | 150 | 44 | 177 | 938 | 8951 | 10.47927606 |
| 26 | Toyota | 04-184-AU | | | 215 | 246 | 313 | 112 | | | | | | | 886 | 7698 | 11.50948298 |
| 27 | Toyota | 04-185-AU | | | 184 | 331 | 286 | 175 | | | | | | | 976 | 8598 | 11.35147709 |
| 28 | Toyota | 04-188-AU | | | 89 | | | | | | | | | | 89 | 636 | 13.99371069 |
| 29 | Galoper | 3Z-152-16 | | | | | | | | | | 144 | | | 144 | 1040 | 13.84615385 |
| 30 | Toyota | 3Z-144-16 | | | | | | | | | | 50 | | | 50 | 640 | 7.8125 |
| 31 | JMS Isuzu | 3Z-125-16 | | | | 177 | | | | | | | | | 177 | 1558 | 11.36071887 |
| 32 | KIA | 3Z-159-16 | | | 100 | | | | | | | | | | 100 | 1280 | 7.8125 |
| 33 | Nissan | 02-656-AU | | | | 152 | 315 | 455 | | | | | | | 922 | 6790 | 13.57879234 |
| | Totali | | 1604 | 1468 | 3359 | 3900 | 4076 | 5205 | 4370 | 4081 | 4184 | 5132 | 2857 | 3516 | 43446 | 425948 | 10.1998366 |

Tabela 4. *Raporti i shpenzimeve të automjeteve, janar – dhjetor 2013*

Duke u bazuar në tabelën e shpenzimeve të automjeteve janar - dhjetor 2013 është evident shpenzimi i rritur i karburanteve në muajt ku numri kontrolleve ka qenë më i madh. Sipas tabelës dhe grafikonit në vijim shihet se volumi ma i madh i punëve e sidomos në kontroll në teren ka qenë nga muaji maj e deri në muajin tetor. Gjithashtu nga grafikoni vijues për shpenzimet për vetura dhe numri i kilometrave për veturë është në suaza të optimales.




Figura 4. *Shpenzimet e karburanteve për vitin 2013*




Figura 5. *Numri i kilometrave të kaluar për veturat e AZHB-së*

Zyrtarët e AZHB janë të pajisur me inventarë dhe pajisje të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve të planifikuara me përjashtim të zyrave regjionale të cilat kanë nevojë për pajisje

shtesë duke marr për bazë se procesi i aplikimit për vitin 2014 do të kryhet në këto zyra. Është pranuar dhe shpërndarë, inventar dhe pajisje të ndryshme si vitrina, printer, aparat telefoni, kamera digjitale, GPS dhe odometër të financuara nga BB dhe tani çdo zyrë regjionale është e pajisur për punë normale në inspektim.

**Zyra Ligjore:** gjatë këtij viti është hartuar Rregullorja e brendshme për sistematizimin e vendeve të punës në AZHB e cila është dërguar dhe proceduar në Ministrin e Administratës Publike.

Janë hartuar modelet e të gjitha vendimeve për Pagesa Direkte, për Projektet e Zhvillimit Rural si dhe vendimeve të tjera sipas nevojës së AZHB - së. Modelet e vendimeve për Pagesa Direkte dhe Projektet e Zhvillimit Rural janë hartuar në bazë të kërkesave të U/A. Këto vendime janë hartuar për mbështetje dhe për refuzim të kërkesave të fermerëve.

Gjatë vitit 2013 të total janë hartuar modelet e 20 vendimeve për nevoja të drejtorive tjera dhe janë ne shfrytëzim.

Me qellim të ngritjes së efikasitetit të punëve dhe aktiviteteve dhe me qellim të monitorimit më të mirë të mundësive financiare të fermerëve AZHB-ja gjatë vitit 2013 ka nënshkruar një mori marrëveshjesh të bashkëpunimit me Raiffaissen Bank, ProCredit Bank, Finca, KEP dhe PTK.
Edhe këtë vit sikurse viteve paraprake në AZHB janë parashtruar ankesa si për Pagesa Direkte po ashtu edhe për Projektet e Zhvillimit Rural. Numri i përgjithshëm i ankesave për të dy drejtoratet është 584 ankesa prej tyre 390 për Divizionin e Pagesa Direkte dhe 194 për Projektet e Zhvillimit Rural.

| | |
|---|---|
| Totali i ankesave - 2013 | 584 |
| Projektet e zhvillimit rural | 194 |
| Pagesat direkte | 390 |




Figura 6. *Numri i përgjithshëm i ankesave për PD dhe PZHR*

| | |
|---|---|
| Numri i ankesave të shqyrtuara | 385 |
| Numri i ankesave të refuzuara | 337 |
| Numri i ankesave të rekomanduara | 89 |




Figura 7. *Numri i shqyrtimit të ankesave për pagesa direkte*

| | |
|---|---|
| Numri i ankesave të pashqyrtuara | 175 |
| Numri i ankesave të refuzuara | 146 |
| Numri i ankesave të rekomanduara | 29 |




Figura 8. *Numri i ankesave pashqyrtuara për PZHR*

Zyra Ligjore e AZHB-së është marrë me evidentimin, kompletimin e lëndëve dhe dorëzimin e tyre në komisionet përkatëse për shqyrtim. Deri në datën e raportimit shumica e ankesave janë shqyrtuar nga komisionet përkatëse dhe janë dërguar rekomandimet si tek drejtoratret po ashtu edhe tek fermerët.

Gjatë procesit të implementimit janë identifikuar gabime teknike ose si pasojë e superkontrolleve dhe monitorimit dhe përfitim i mjeteve financiare në kundërshtim me kushtet dhe kritereve të përcaktuara me U/A për Projektet e Zhvillimit Rural dhe Pagesat Direkte, andaj është kërkuar kthimi i këtyre mjeteve nga fermerët.

Gjatë këtij viti kemi bërë dhjetë kërkesa për kthimin e mjeteve ku tre prej tyre janë përgjigjur në mënyrë pozitive, dy për Projektet e Zhvillimit Rural dhe një për Pagesat Direkte. Për mos përgjigje në kërkesën për kthimin e mjeteve janë ngritur shtatë padi në Gjykatat Themelore, kurse për një lëndë është kërkuar zhvillimi i procedurave për krime ekonomike.

Bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës Ligjore të AZHB-së është bërë edhe monitorimi i zbatimit të U/A i bazuar në numrin dhe natyrën e ankesave që kanë ardhur dhe kemi arritur te konstatimi:

- Procedurat e Pagesave Direkte janë zbatuar nga Divizioni i Pagesave Direkte në pajtim me U/A për Pagesat Direkte për vitin 2013, përveç se lista e fermerëve të cilat janë të përjashtuar për tri vite duhet të unifikohet.
- Procedurat e shkruara për Projektet e Zhvillimit Rural janë zbatuar në pajtim më U/A për masat dhe kriteret e përkrahjes në bujqësi dhe zhvillim rural për vitin 2013, përveç në rastet e nenit 22 pika e dytë për kompletim të dokumentacionit ku fermerëve nuk i'u është bërë kërkesë me shkrim për kompletim të dokumenteve dhe në këtë mënyrë janë refuzuar, mosshpërndarja e vendimeve me kohë si dhe të aplikohet lista e fermerëve që janë të përjashtuar për tri vitet nga programet përkrahëse për të gjitha Masat e Projektet e Zhvillimit Rural dhe Pagesat Direkte ashtu edhe siç e parasheh edhe Ligji për bujqësi dhe zhvillim rural.

**Arkiva** gjatë vitit 2013 është funksionalizuar në tërësi. Janë zhvilluar të gjitha procedurat konform ligjit dhe rregulloreve për arkiva. Të gjitha divizionet kanë referencë të veçantë dhe distribuimi i shkresave hyrëse dhe dalëse është realizuar sipas planit.

Gjatë këtij viti është funksionalizuar edhe arkiva si objekt dhe është pajisur me sirtarë dhe tani është duke u mirëmbajtur. Janë arkivuar të gjitha dosjet si të Pagesa Direkte po ashtu edhe të Projektet e Zhvillimit Rural për dy vitet paraprake.

Gjatë vitit 2013 përmes arkivës janë proceduar 29,581 shkresa te ndryshme si vendime, ankesa, kërkesa, rekomandime, kontrata dhe shkresa te tjera te natyrës administrative.

# Divizioni i Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural

Mbështetja për Investime në fermat/ekonomitë bujqësore është i një rëndësie vendimtare për të përmirësuar Sektorin e Bujqësisë në Kosovë, duke mbështetur komunitetin bujqësor dhe rural të arrijnë standarde më të larta të jetesës dhe përmirësohet kualiteti i prodhimeve dhe përpunimeve të ndryshme bujqësore.

Gjatë vitit 2013 nga Divizioni i Projekteve të Zhvillimit Rural është bërë zbatimi i Projekteve të Zhvillimit Rural – duke përfshirë Masat që kanë dalë nga Projektet e Zhvillimit Rural 2013 e që janë:

- ✓ Masa 2 - "Ristrukturimi i potencialit fizik në sektorin Agro-Rural",
- ✓ Masa 3 - "Ujitja e Tokave Bujqësore",
- ✓ Masa 4 – "Investimet në Përpunim dhe Marketingun e Prodhimeve Bujqësore",
- ✓ Masa 8 – "Përkrahje për Zhvillimin e Komunitetit Lokal ( GLV-të)",
- ✓ Pilot Masa – "Zonat më pakë të zhvilluara".

**<u>Masa 2</u>** – "Ristrukturimi i potencialit fizik në sektorin Agro-Rural" - përfshinë:

- Nën-Masën "Hortikulturë me sektorët (pemë, perime, rrush të tryezës, fruta të malit, bimë mjekuese dhe mekanizim bujqësor)" ,
- Nën-Masat „Ekonomitë bujqësore për prodhimin e qumështit",
- Nën-Masa "Ekonomitë bujqësore për prodhimin e vezëve",
- Sektorin i Mishit ( viça dhe brojler ) si dhe
- Sektori i Bletarisë.

**Objektivi i përgjithshëm i Masës 2:**

- Përmirësimi i strukturës të ekonomive bujqësore përmes rritjes së prodhimtarisë dhe përmirësimit të cilësisë.

**Objektivat e përgjithshme të Masës 3:**

- Rritja e produktivitetit,
- Rritja e rendimentit dhe cilësisë së prodhimeve bujqësore,
- Rritja e aftësive konkurruese të prodhimeve bujqësore.

**Objektivat e përgjithshme të Masës 4:**

- Të rrisë kapacitetin e përpunimit dhe produktivitetit duke zbatuar teknologjitë moderne,
- Të përmirësoj higjienën dhe cilësinë e standardeve vendore për përpunimin e produkteve agro-ushqimore,
- Të inkurajojë përdorimin e teknologjive të reja që e ruajnë mjedisin.

**Objektiva e përgjithshme e Masës 8 është t'u ofroj përkrahje në:**

- Programe të bazuara në zona që kanë për qëllim identifikimin e mirë të territoreve rurale,
- Zbatimin e projekteve bashkëpunuese.

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë gjegjësisht Divizioni për Projekte të Zhvillimit Rural gjatë vitit 2013 ka bërë zbatimin e Programit për Zhvillim Rural.

Realizueshmëria e Projekteve të Zhvillim Rural për kryerjen e aktiviteteve ka rrjedhur sipas planit të paraparë.




Tabela 5. *Realizueshmëria e Projekteve të Zhvillim Rural*

Ecuria e realizimit të Projekteve të Zhvillimit Rural ka përfshirë hapat si:

- Aplikimi,
- Kontroll administrative,
- Vlerësimi,
- Kontrolli në terren,
- Miratimi i projekteve si dhe
- Autorizimi për pagesa.

Buxheti i paraparë për vitin 2013 për Projektet e Zhvillimit Rural:

| Tabela e buxhetit të masave të propozuara | | |
|---|---|---|
| | Masa 2 Ristrukturimi i Potencialit Fizik në Sektorin Agro-Rural | **6,650,000 €** |
| | Nënmasat | |
| **a)** | Sektori i qumështit | **1,000,000 €** |
| **b)** | Sektori i vezëve | **300,000 €** |
| **c)** | Sektori i mishit | **700,000 €** |
| **ç)** | Sektori i bletarisë | **250,000 €** |
| **d)** | Sektori i pemëve | **1,200,000 €** |
| **dh)** | Sektori i rrushit të tryezës | **200,000 €** |
| **e)** | Sektori i perimtarisë | **1,400,000 €** |
| **f)** | Sektori i frutave të malit dhe bimëve mjekuese | **300,000 €** |
| **g)** | Sektori i makinerisë bujqësore | **1,300,000 €** |
| | Masa 3 Ujitja e tokave bujqësore | **1,000,000 €** |
| | Masa 4 Investimet në Përpunim dhe Marketingun e Produkteve Bujqësore | **3,000,000 €** |
| | Masa 4 Investimet në Përpunim dhe Marketingun e Produkteve Bujqësore / Ndërtimi i Depove | **2,500,000 €** |
| | Masa 8 Përkrahje për zhvillimin e komunitetit lokal | **200,000 €** |
| | Zona më pak të favorizuar ( Pilot Masa) | **1,500,000 €** |
| | TOTALI | 14,850,000 € |

Tabela 6. *Buxheti për projektet e zhvillimit rural sipas Masave*

Në tabelën nr. 5 gjendet numri i aplikuesve për Projektet e Zhvillimit Rural, vlera e aplikuar, numri i aplikacioneve të miratuara dhe vlera e miratuar, për të gjitha Masat e parapara nga Programi i Zhvillimit Rural të zbatuar gjatë vitit 2013.

Gjithashtu duhet cekur se edhe për masën 4 Masa- "Investimet në përpunim dhe marketingun e produkteve bujqësore/ Ndërtimi i Depove" është bërë vazhdimi i zbatimit të këtyre projekteve me një vlerë prej 1,500,000.00€

| Nr. | Nën-masat | Numri i aplikacioneve | Vlera e aplikuar | Numri i aplikacioneve të miratuara | Vlera e aplikacioneve të miratuara |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Hortikulurë- vreshtari | 58 | 719,912.67 | 41 | 214,621.81 |
| 2 | MS - Produktet jodrusore të malit: frutat e malit, kërpudhat dhe bimët aromatike dhe mjekësore | 8 | 1,177,716.00 | 4 | 173,325.00 |
| 3 | Sektori i qumështit | 444 | 19,998,425.66 | 43 | 1,195,345.76 |
| 4 | Sektori i vezëve | 42 | 2,301,024.60 | 13 | 325,322.40 |
| 5 | Sektori i mishit- viça dhe brojler | 86 | 3,853,403.38 | 32 | 596,526.45 |
| 6 | Sektori i bletarisë | 249 | 3,011,201.23 | 31 | 223,638.35 |
| 7 | M4 Prodhimtaria e qumështit | 25 | 5,054,294.04 | 9 | 1,255,117.66 |
| 8 | M4 Mishi dhe Përpunimi i mishit | 26 | 6,968,866.62 | 8 | 1,270,770.60 |
| 9 | M4 Sektori i Përpunimit dhe marketingut të frutave, perimeve dhe verës 2013 | 58 | 8,480,205.92 | 12 | 1,309,938.92 |
| 10 | Ujitja e tokave bujqësore | 101 | 3,742,695.86 | 25 | 1,206,428.03 |
| 11 | GLV-të | 39 | 835,849.70 | 15 | 231,105.70 |
| 12 | M2 Sektori i perimeve - serave | 815 | 18,365,078.78 | 47 | 1,218,457.11 |
| 13 | Sektori i pemëve - Ngritja e pemishteve me mollë | 340 | 7,439,019.20 | 30 | 826,966.73 |
| 14 | Mollë - Sektori i pemëve - Infrastrukturë në pemishte | 105 | 855,851.39 | 18 | 61,269.65 |
| 15 | Pemët e imëta -(dredhëz, manafer, mjeder) | 339 | 3,158,275.12 | 22 | 369,512.65 |
| 16 | Sektori i frutave - Sektori i frutave të malit dhe bimeve mjekuese | 34 | 838,235.25 | 14 | 192,897.90 |
| 17 | Mekanizëm Bujqësor - Lavërtari | 625 | 11,268,548.22 | 30 | 774,281.30 |
| 18 | Mekanizëm Bujqësor - Blegtori – Pemëtari, Vreshtari - Perimekulturë | 246 | 4,701,217.98 | 17 | 497,324.10 |
| 19 | MS - Mbështetje Prodhimit të qumështit dhe mishit (lopët qumështore dhentë dhe dhitë) | 73 | 1,463,901.09 | 59 | 619,129.80 |
| 20 | MS - Investimet e pranueshme për ripërtypësit e imtë-dele | 15 | 338,026.35 | 14 | 188,077.50 |
| 21 | MS - Investimet e pranueshme për ripërtypësit e imtë-dhi | 4 | 42,176.90 | 3 | 17,998.50 |
| 22 | Perimet në ambient të hapur | 171 | 321,142.00 | 91 | 161,191.80 |
| | TOTALI | 3,903 | 104,935,067.96 | 578 | 12,929,247.72 |

Tabela 7. *Numri i aplikuesve për Projektet e Zhvillimit Rural*




Figura 9. *Krahasimi i numrit të aplikuesve për PZHR 2010-2013*




Figura 10. *Vlera e aplikuar në tabelën e mësipërme për vitin 2013 është paraqitur vetëm përkrahja publike*

## Vështirësitë e hasura gjatë Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural

1. Stafi i limituar në procesin e vlerësimit, miratimit dhe autorizimit të Projekteve të Zhvillimit Rural;
2. Thirrja për aplikim sipas periudhës vegjetative;
3. Specifikimi i dokumentacionit përkatës p.sh:( dokumentet që kërkohen të specifikohet ku duhet të merren);
4. Përkrahja e perimeve në ambient të hapur jo si grante;
5. Mekanizimi të jetë së bashku me sektorët përkatëse;
6. Vlerësimi për këta sektor, sektori përkatës dhe mekanizimi të jetë unik (vetëm një vlerësim);
7. Ndoshta shkallëzimi i buxhetit për sektorin e serave;
8. Vlerësimi të specifikohet mirë p.sh. shkolla e mesme bujqësore dhe fermerët tjerë;
9. Një numër i madh i dokumentacioneve të pa kompletuara kanë ardhur nga ana e Komunave.
10. Regjistri i Fermës ( mos të ketë mundësi regjistrimi i ma shumë se një familjari të kërkohet certifikata e lindjes);
11. Përcaktimi i kritereve për ndërtimin e objekteve përkrahëse ( p.sh: shtalla, gropa septike, deponia e plehut , serrat etj);
12. Specifikimi i qartë i fushave të investimit të Masa 4;
13. Përcaktimi i krerëve në posedim te pulat vojse, dhe mishi pasi bëhet ndërrimi i tornuseve prodhuese.

# Divizioni i Autorizimit të Pagesave

Në bazë të Udhëzimit Administrativë 03/2013 Divizioni për Autorizim të Pagesave për PZHR ka bërë autorizimin e pagesave për këto masa:

**Masa2 - "Ristrukturimi i potencialit fizik në sektorin agro-rural"** duke përfshi Nën-masën:

**Masa 3 - Ujitja e Tokave Bujqësore,**

**Masa 4 – Investimet në Përpunim dhe Marketing të Prodhimeve Bujqësore,**

**Masa4 - Investimet në Përpunim dhe Marketing të Prodhimeve Bujqësore (Ndërtimi i Depove),**

**Masa 8 - Përkrahje për zhvillimin e komunitetit Lokal ( GLV-te),**

**Pilot Masa - Zonat me pak të favorizuara.**

Gjatë vitit 2013 janë kryer pagesat nga Buxheti Nacional dhe Banka Botërore. Projektet e paguar në vitin 2013 kanë qenë kësti i dytë i pikave grumbulluese, 50% avans për Pilot Masën, 50% avans për Masën e 4 është paguar 50%e vlerës së projekteve më të madhe se 30.000 €.

| Masa | Numri i përfituesve | Vlera e paguar |
|---|---|---|
| Pikat grumbulluese (30%) | 3 | 900,000.00 |
| Masa speciale (50%) | 79 | 477,889.85 |
| TOTALI | | 1,377,889.85 |

Tabela 8. *Buxhet nacional për vitin 2013*

| Masa | Nën-masa | Numri i përfituesve | Vlera e paguar |
|---|---|---|---|
| Masa 2 | Pemë | 9 | 233.402,05 |
| | Sera | 43 | 857.097,17 |
| | Qumësht | 7 | 155.033,41 |
| | Mekanizëm | 11 | 353.030,25 |
| Masa 4 | | 28 | 1.817.913,58 |
| **TOTALI** | | **98** | **3.416.476,46** |

Tabela 9. *Buxheti i Bankës Botërore për vitin 2013*




Figura 11. *Paraqitja grafike e numrit të përfituesve të financuar nga Banka Botërore për vitin 2013*

Procesi i pagesave për të gjitha projektet tjera ka vazhduar në vitin 2014 për të gjitha projektet e mbetura për masat 2, 3, 8, Pilot Masa (kësti i dytë), Masa 4 (kësti i dytë) si dhe pagesa e këstit të tretë për pikat grumbulluese. Projektet për masën 3, 8, Pilot Masës dhe projektet e Masës 2 me vlerë më të vogël se 15,000.00 € janë paguar me buxhet nacional.

| Masa | Nën-masa | Numri i përfituesve | Vlera e paguar | Buxheti Banka Botërore | Buxheti i Danidës |
|---|---|---|---|---|---|
| Masa 2 | Pemë | 25 | 156.076,15 | 479.568,86 | 471.359,38 |
| | Pemë të imëta | 15 | 210.657,67 | | |
| | Vreshta | 35 | 126.383,00 | | |
| | Fruta mali | 13 | 163.670,51 | | |
| | Bletari | 30 | 200.688,27 | | |
| | Qumësht | 32 | 474.979,00 | | |
| | Perime | 75 | 73.803,96 | | |
| | Mekanizëm | 12 | 82.381,00 | | |
| Masa 3 | Ujitje | 25 | 993.935,81 | | |
| Masa 8 | GLV | 15 | 194.059,89 | | |
| Masa speciale | | 79 | 892.816,69 | | |
| **TOTALI** | | **356** | **3.569.451,95** | **479568,86** | **471359,38** |
| | | | | | **4.520.380,19** |

Tabela 10. *Buxhet nacional për vitin 2014*




Figura 12. *Paraqitja grafike e numrit të përfituesve nga buxheti i përgjithshëm*

Projektet e Masës 2 në vlerë më të madhe se 15000 € dhe Masës 4 kësti i dytë janë paguar nga buxheti i Danidës.

| Masa | Nën-masa | Numri i përfituesve | Vlera e paguar |
|---|---|---|---|
| Masa 2 | Pemë | 10 | 228.358,58 |
| | Pemë të imëta | 7 | 105.000,00 |
| | Vreshta | 1 | 38.871,25 |
| | Sera | 4 | 80.000,00 |
| | Qumësht | 36 | 736.829,39 |
| | Mekanizëm | 15 | 329.553,62 |
| Masa 4 | | 25 | 1.462.150,53 |
| TOTALI | | 98 | 2.980.763,37 |

Tabela 11. *Buxheti i Danidës për vitin 2014*




Figura 13. *Paraqitja grafike e buxhetit të Danidës për vitin 2014*

Po ashtu në këtë vit ( 2014 ) është paguar dhe kësti i tret ( 20 % avans ) për tri pikat grumbulluese:

| Masa | Numri i përfituesve | Vlera e paguar |
|---|---|---|
| Pikat grumbulluese (20 % avans) | 3 | 600,000.00 |

Tabela 12. *Buxhet nacional për vitin 2013*

Nga tabelat e mësipërme shihet se pagesa e bëra për projekte e zhvillimit rural 2013 janë sipas buxheteve.

| Buxheti | Vlerat e paguara |
|---|---|
| Buxheti nacional | 6.020.380,19 |
| Buxheti i Bankës Botërore | 3.416.476,46 |
| Buxheti i Danidës | 2.980.763,37 |
| Totali | 12.417.620,02 |

Tabela 13. *Shuma totale e buxhetit për projektet e zhvillimit rural për vitin 2013*




Figure 14. *Paraqitja grafike e Pagesat sipas buxheteve*

Siç shihet nga tabelat e mësipërme numri i përfituesve për Projekte të Zhvillimit Rural për vitin 2013 për të gjitha masat është:

| Masa | Nën-masa | Numri i përfituesve |
|---|---|---|
| Masa 2 | Pemë | 44 |
| | Sera | 47 |
| | Pemë të imëta | 22 |
| | Vreshta | 36 |
| | Fruta mali | 13 |
| | Bletari | 30 |
| | Qumësht | 75 |
| | Perime | 75 |
| | Mekanizëm | 38 |
| Masa 3 | Ujitje | 25 |
| Masa 8 | GLV | 15 |
| Pilot masa | | 79 |
| Masa 4 - Përpunim | | 28 |
| Pikat grumbulluese | | 3 |
| Totali | | 530 |

Tabela 14. *Paraqitja tabelore e numrit të përfituesve për projektet e Zhvillimit Rural*




Figura 15. *Paraqitja grafike e numrit të përfituesve të projekteve të Zhvillimit Rural*

Një numër i fermerëve dhe kompanive të cilat kanë qenë përfitues të projekteve por që nuk kanë arritur ti përfundojnë projektet në bazë të afateve të caktuar dhe kritereve të parapara, 22 prej tyre i është refuzuar kërkesa për pagesë. Tek masa 4 dhe Pilot masa 8 fermerë janë paguar në këstin e parë por nuk kanë arritur ti realizojnë investimet për të marrë këstin e dytë të pagesës.

| Masa | Numri |
|---|---|
| Perime | 8 |
| MS (këstin e dytë ) | 5 |
| Stalla | 4 |
| Betari | 1 |
| Mekanizëm | 1 |
| Përpunim (kësti i dytë ) | 3 |
| Totali | 22 |

Tabela 15. *Numri i të refuzuarve sipas masave*

# Divizioni i Pagesave Direkte

## Mbjellje vjeshtore– Grurë

Mbështetja e fermerëve për mbjelljet vjeshtore- grurë përmes Pagesave Direkte ka vazhduar edhe gjatë vitin 2013 ku është karakterizuar me një numër me të madh të aplikuesve se sa në vitet tjera. Numri i fermerëve që merren me këtë veprimtari po rritet nga viti në vit gjithashtu edhe sipërfaqet e mbjellura me grurë.

Fermerët që kanë aplikuar për Pagesa Direkte - Grurë është dashur të plotësojnë këto kritere:

- Të jetë banor i përhershëm i Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellur 2 apo më shumë hektar me Grurë;
- Parcela e marrë me qira duhet të jetë 1 Ha e pandarë.

Aplikimi është bërë në Zyrat Komunale për Bujqësi. Aplikimi është bërë në mënyrë online përmes softwar-it sLPIS.

Pas përfundimit te aplikimit ka filluar kontrolli administrativ i aplikacioneve ku janë kontrolluar të gjitha aplikacionet lidhur me përshtatshmërinë me kriteret dhe dokumentet e kërkuara.

Pas kontrollit administrativ të aplikacioneve është përzgjedhur mostra për kontroll në terren.

Janë kontrolluar në masën 100% të gjithë fermerët që kane aplikuar për 5 Ha grurë e më shumë.

Fermerët që kanë pasur sipërfaqe të mbjellura me grurë në mes te 2 dhe 5 Ha janë kontrolluar në masën 50%.

Në ato komuna ku është vërejtur se ka parregullsi gjatë kontrollit në terren është ngritur përqindja e kontrollit nga 50% ne 100% siç ishte rasti ne komune e Malishevës, Novobërdës dhe Suharekës.

Pas përfundimit të kontrollit në terren të gjitha raportet e kontrollit janë kthyer në Divizionin e Pagesave Direkte dhe të gjitha të dhënat rreth të gjeturave janë futur në program ku është bërë kalkulimi i pagesave dhe janë përgatitur listat e përfituesve dhe të refuzuarve.

Gjatë aplikimit ende ka probleme te fermerët në identifikimin e parcelave tokësore, pastaj problem mbetet fletaposeduese e cila në shumicën e rasteve nuk përputhet me gjendjen faktike në terren. Numri me i madh i fermerëve përfitues janë fermer të vegjël që kanë midis dy dhe pesë hektar, ky numër është 8,762 fermer me gjithsej 25,853.88 Ha.

| Nr | Komuna | Nr. Aplikusve | Sipërfaqja e aplikuar | Nr. i fermerëve përfitues | Nr. i fermerëve te refuzuar | Nr. i ha te refuzuar | Sip. e subvencionuar | % e fermerëve te refuzuar | % e hektarëve te refuzuar | Pagesa (Euro) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Prishtina | 157 | 580.95 | 124 | 33 | 96.98 | 483.97 | 21.02 | 16.69 | 60,496.25 |
| 2 | Lipjani | 854 | 4741.18 | 799 | 55 | 653.3 | 4087.88 | 6.44 | 13.78 | 510,985.00 |
| 3 | Podujeva | 929 | 3586.45 | 841 | 88 | 293.44 | 3293.01 | 9.47 | 8.18 | 411,626.25 |
| 4 | Obiliqi | 241 | 1308.95 | 228 | 13 | 41.19 | 1267.76 | 5.39 | 3.15 | 158,470.00 |
| 5 | Drenasi | 561 | 2330.46 | 532 | 29 | 90.52 | 2239.94 | 5.17 | 3.88 | 279,992.50 |
| 6 | F.Kosova | 194 | 940.71 | 181 | 13 | 69.29 | 871.42 | 6.70 | 7.37 | 108,927.50 |
| 7 | Graqanica | 317 | 969.58 | 265 | 52 | 144.43 | 825.15 | 16.40 | 14.90 | 103,143.75 |
| 8 | Dragashi | 17 | 75.37 | 15 | 2 | 26.77 | 48.6 | 11.76 | 35.52 | 6,075.00 |
| 9 | Rahoveci | 493 | 1773.45 | 461 | 32 | 106.45 | 1667 | 6.49 | 6.00 | 208,375.00 |
| 10 | Prizreni | 237 | 894.97 | 220 | 17 | 45.51 | 849.46 | 7.17 | 5.09 | 106,182.50 |
| 11 | Suhareka | 329 | 1091.77 | 200 | 129 | 403.66 | 688.11 | 39.21 | 36.97 | 86,013.75 |
| 12 | Malisheva | 721 | 3458.16 | 578 | 143 | 647.99 | 2810.17 | 19.83 | 18.74 | 351,271.25 |
| 13 | Mamushe | 32 | 105.34 | 29 | 3 | 9.09 | 96.25 | 9.38 | 8.63 | 12,031.25 |
| 14 | Gjilani | 295 | 1166.26 | 277 | 18 | 51.07 | 1115.19 | 6.10 | 4.38 | 139,398.75 |
| 15 | Kamenica | 286 | 904.98 | 258 | 28 | 79.71 | 825.27 | 9.79 | 8.81 | 103,158.75 |
| 16 | Vitia | 505 | 2043.18 | 464 | 41 | 133.51 | 1909.67 | 8.12 | 6.53 | 238,708.75 |
| 17 | N. Berd | 194 | 531.47 | 139 | 55 | 155.44 | 376.03 | 28.35 | 29.25 | 47,003.75 |
| 18 | Partesh | 7 | 22.15 | 6 | 1 | 3.36 | 18.79 | 14.29 | 15.17 | 2,348.75 |
| 19 | Ranilluk | 25 | 71.23 | 16 | 9 | 20.54 | 50.69 | 36.00 | 28.84 | 6,336.25 |
| 20 | Kllokot | 52 | 177.94 | 43 | 9 | 26.37 | 151.57 | 17.31 | 14.82 | 18,946.25 |
| 21 | Ferizaji | 573 | 3068.56 | 529 | 44 | 128.61 | 2939.95 | 7.68 | 4.19 | 367,493.75 |
| 22 | Shtimja | 254 | 1198.1 | 246 | 8 | 22.05 | 1176.05 | 3.15 | 1.84 | 147,006.25 |
| 23 | Kaçaniku | 124 | 478.44 | 122 | 2 | 6.53 | 471.91 | 1.61 | 1.36 | 58,988.75 |
| 24 | Shterpcë | 3 | 8.65 | 2 | 1 | 2.3 | 6.35 | 33.33 | 26.59 | 793.75 |
| 25 | H. Elezit | 19 | 62.55 | 16 | 3 | 9.67 | 52.88 | 15.79 | 15.46 | 6,610.00 |
| 26 | Mitrovica | 130 | 493.89 | 122 | 8 | 36.99 | 456.9 | 6.15 | 7.49 | 57,112.50 |
| 27 | Skenderaj | 1246 | 4851.57 | 1186 | 60 | 286.29 | 4565.28 | 4.82 | 5.90 | 570,660.00 |
| 28 | Vushtrri | 591 | 2004.03 | 557 | 34 | 119.84 | 1884.19 | 5.75 | 5.98 | 235,523.75 |
| 29 | Zveqan | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 30 | Leposaviq | 36 | 93.12 | 32 | 4 | 17.01 | 76.11 | 11.11 | 18.27 | 9,513.75 |
| 31 | Z.Potok | 1 | 2.02 | 1 | 0 | 0 | 2.02 | 0.00 | 0.00 | 252.50 |
| 32 | Deçani | 129 | 444.06 | 122 | 7 | 23.68 | 420.38 | 5.43 | 5.33 | 52,547.50 |
| 33 | Gjakova | 542 | 2503.09 | 519 | 23 | 114.42 | 2388.67 | 4.24 | 4.57 | 298,583.75 |
| 34 | Junik | 24 | 199.44 | 23 | 1 | 2.17 | 197.27 | 4.17 | 1.09 | 24,658.75 |
| 35 | Peja | 211 | 1523.01 | 177 | 34 | 559.71 | 963.3 | 16.11 | 36.75 | 120,412.50 |
| 36 | Istogu | 677 | 3550.28 | 648 | 29 | 166.93 | 3383.35 | 4.28 | 4.70 | 422,918.75 |
| 37 | Klina | 752 | 4235.09 | 708 | 44 | 301.49 | 3933.6 | 5.85 | 7.12 | 491,700.00 |
| | TOTALI | 11758 | 51490.45 | 10686 | 1072 | 4896.31 | 46594.14 | 9.12 | 9.51 | 5,824,267.50 |

Tabela 16. *Fermerët përfitues dhe të refuzuar sipas komunave për Pagesa Direkte- Grurë*




Figura 16. *Krahasimi i shumës së pagesave për vitin 2011, 2012, 2013*

Siç po shihet edhe nga tabela e mësipërme dhe grafikoni, shuma e pagesës për sipërfaqet e mbjellura me grurë në krahasim me vitin 2012 është rritur për 2,017,142.25€ ose shprehur në përqindje për 22.52 %, kjo për arsye se në vitin 2013 kemi pasur një sipërfaqe të mbjellur me grurë për 8,546.95 Ha më shumë se në vitin 2012 dhe gjithashtu shuma e subvencionimit /Ha ka qenë me e madhe për 25% (125 euro/Ha). Derisa në vitin 2012 janë paguar 37,950.94 Ha, në vitin 2013 janë paguar 46,594.14 Ha.

Rritja e shumës së subvencionimit nga 100€/Ha sa ishte në vitin 2012 në 125€/Ha në vitin 2013 ka ndikuar që të rriten sipërfaqet e mbjellura me grurë.

Numri i fermerëve të refuzuar pas kontrollit në terren është 1,072 fermer ose 9.12 % e fermerëve aplikues.

Prej 1,072 fermerëve të refuzuar, 522 janë ndëshkuar për tri vitet e ardhshme për shkak të të dhënave jo të sakta që kanë paraqitur në aplikim. Këta fermer nuk kanë të drejtën të aplikojnë në asnjërën prej kategorive të mbështetjes nga AZHB-MBPZHR.

## Farë Gruri

Edhe këtë vit AZHB-ja ka subvencionuar prodhuesit e farës së grurit. Kriteri minimal për aplikim ka qenë 5 ha, ndërsa ai maksimal 100 ha të mbjellura me grurë.

Në këtë kategori kanë përfituar gjithsej 27 fermer me 849.60 Ha. Shuma totale e pagesës për fermerët përfitues ka qenë gjithsej 63,720.00 €. Kontrolli ne terren është kryer nga inspektorët fitosanitar.

Të gjithë fermerët aplikues që kanë plotësuar kriteret paraprake janë kontrolluar nga dy herë nga inspektorët fitosanitar, ndërsa pagesa për fermerët përfitues është bërë konform sasisë së grurit të dorëzuar te kontraktuesit. Krahasuar me vitin 2012 sipërfaqja e subvencionuar është rreth 600 Ha me e madhe. Shuma e subvencionimit ka qene 200€/Ha.

| Nr. | Komuna | Nr. i përfituesve | Sipërfaqja Ha | Shuma |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Istog | 6 | 161.80 | 12.135.00 |
| 2 | Peje | 1 | 77.60 | 5.820.00 |
| 3 | Gjakove | 3 | 34.30 | 2.572.50 |
| 4 | Kline | 7 | 257.70 | 19.327.50 |
| 5 | Ferizaj | 3 | 139.30 | 10.447.50 |
| 6 | Vushtrri | 1 | 5.10 | 382.50 |
| 7 | Suhareke | 1 | 61.70 | 4.627.50 |
| 8 | Deçan | 1 | 5.40 | 405.00 |
| 9 | F.Kosove | 1 | 29.60 | 2.220.00 |
| 10 | Junik | 1 | 44.00 | 3.300.00 |
| 11 | Lipjan | 1 | 8.70 | 652.50 |
| 12 | Malisheve | 1 | 24.40 | 1.830.00 |
| | **TOTALI** | **27** | **849.60** | **63.720.00** |

Tabela 17. *Përfituesit dhe sipërfaqja e subvencionuar për prodhuesit e farës së grurit sipas komunave*




Figura 17. *Krahasimi i shumës së pagesës për fare gruri për vitin 2012 dhe 2013*

# Misër

AZHB-ja ka subvencionuar edhe këtë vit fermerët që kanë mbjellur sipërfaqet e tokës me misër. Subvencionimi është bërë për sipërfaqet e mbjellura për të gjithë fermerët që kanë mbjellur më tepër se një hektar misër. Fermerët që kanë aplikuar për subvencionim të misrit janë kontrolluar në masën 50%.

Fermerët aplikues kanë bërë digjitalizimin e parcelave të mbjellura në Zyrat Komunale për Bujqësi. Të dhënat e paraqitura gjatë aplikimit për sipërfaqet e mbjellura kanë qenë relativisht të sakta. Janë refuzuar 6.01 % e fermerëve ose 5.73% e sipërfaqes së aplikuar. Për subvencionim të misrit kanë aplikuar 3,858 fermer me gjithsej 10,003.66 Ha.

Pas kryerjes së kontrollit në terren dhe procedurave tjera, kanë përfituar 3,626 fermer me një sipërfaqe prej 9,430.27 Ha. Shuma totale e pagesës për të gjithë fermerët përfitues është 943,027.60 €.

| Nr | Komuna | Nr. Aplikusve | Sipërfaqja e aplikuar | Nr. i fermerëve përfitues | Nr. i fermerëve te refuzuar | Nr. i ha te refuzuar | Sip.e subvencionuar | % e fermerëve te refuzuar | % e hektarëve te refuzuar | Pagesa (Euro) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Prishtina | 31 | 75.2 | 23 | 8 | 19.67 | 55.53 | 25.81 | 26.16 | 5,553.00 |
| 2 | Lipjani | 253 | 741.46 | 236 | 17 | 30.56 | 710.9 | 6.72 | 4.12 | 71,090.00 |
| 3 | Podujeva | 211 | 466.2 | 188 | 23 | 66.69 | 399.51 | 10.90 | 14.31 | 39,951.00 |
| 4 | Obiliqi | 67 | 180.97 | 56 | 11 | 25.23 | 155.74 | 16.42 | 13.94 | 15,574.00 |
| 5 | Drenasi | 158 | 492.71 | 153 | 5 | 10.77 | 481.94 | 3.16 | 2.19 | 48,194.00 |
| 6 | F.Kosova | 42 | 196.28 | 41 | 1 | 1.03 | 195.25 | 2.38 | 0.52 | 19,525.00 |
| 7 | Graqanica | 101 | 168.72 | 99 | 2 | 2.75 | 165.97 | 1.98 | 1.63 | 16,597.00 |
| 8 | Dragashi | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.00 | 0.00 | - |
| 9 | Rahoveci | 319 | 842.73 | 292 | 27 | 87.94 | 754.79 | 8.46 | 10.44 | 75,479.00 |
| 10 | Prizreni | 44 | 150.26 | 41 | 3 | 7.03 | 143.23 | 6.82 | 4.68 | 14,323.00 |
| 11 | Suhareka | 56 | 117.92 | 53 | 3 | 6.14 | 111.78 | 5.36 | 5.21 | 11,178.00 |
| 12 | Malisheva | 170 | 412.956 | 149 | 21 | 42.8 | 370.156 | 12.35 | 10.36 | 37,015.60 |
| 13 | Mamushe | 4 | 14.73 | 3 | 1 | 5.08 | 9.65 | 25.00 | 34.49 | 965.00 |
| 14 | Gjilani | 55 | 115.02 | 50 | 5 | 5.93 | 109.09 | 9.09 | 5.16 | 10,909.00 |
| 15 | Kamenica | 54 | 87.57 | 53 | 1 | 1.35 | 86.22 | 1.85 | 1.54 | 8,622.00 |
| 16 | Vitia | 104 | 269.88 | 103 | 1 | 1 | 268.88 | 0.96 | 0.37 | 26,888.00 |
| 17 | N.Berda | 45 | 67.19 | 35 | 10 | 15.63 | 51.56 | 22.22 | 23.26 | 5,156.00 |
| 18 | Partesh | 17 | 33.69 | 16 | 1 | 1.04 | 32.65 | 5.88 | 3.09 | 3,265.00 |
| 19 | Ranilluk | 3 | 4.53 | 3 | 0 | 0 | 4.53 | 0.00 | 0.00 | 453.00 |
| 20 | Kllokot | 23 | 43.69 | 22 | 1 | 1.22 | 42.47 | 4.35 | 2.79 | 4,247.00 |
| 21 | Ferizaji | 181 | 548.97 | 173 | 8 | 10.16 | 538.81 | 4.42 | 1.85 | 53,881.00 |
| 22 | Shtimja | 112 | 314.49 | 107 | 5 | 6.52 | 307.97 | 4.46 | 2.07 | 30,797.00 |
| 23 | Kaçaniku | 36 | 83.57 | 28 | 8 | 12.19 | 71.38 | 22.22 | 14.59 | 7,138.00 |
| 24 | Shterpcë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.00 | 0.00 | - |
| 25 | H.Elezit | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.00 | 0.00 | - |
| 26 | Mitrovica | 28 | 93.21 | 25 | 3 | 4.56 | 88.65 | 10.71 | 4.89 | 8,865.00 |
| 27 | Skenderaj | 458 | 740.95 | 440 | 18 | 27.29 | 713.66 | 3.93 | 3.68 | 71,366.00 |
| 28 | Vushtrri | 170 | 409.83 | 160 | 10 | 27.12 | 382.71 | 5.88 | 6.62 | 38,271.00 |
| 29 | Zveqan | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.00 | 0.00 | - |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 30 | Leposaviq | 1 | 2.1 | 1 | 0 | 0 | 2.1 | 0.00 | 0.00 | 210.00 |
| 31 | Z.Potok | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.00 | 0.00 | - |
| 32 | Deçani | 122 | 311.78 | 119 | 3 | 5.36 | 306.42 | 2.46 | 1.72 | 30,642.00 |
| 33 | Gjakova | 237 | 629.56 | 231 | 6 | 18.24 | 611.32 | 2.53 | 2.90 | 61,132.00 |
| 34 | Junik | 15 | 30.99 | 15 | 0 | 0 | 30.99 | 0.00 | 0.00 | 3,099.00 |
| 35 | Peja | 159 | 615.46 | 150 | 9 | 25.71 | 589.75 | 5.66 | 4.18 | 58,975.00 |
| 36 | Istogu | 349 | 1035.75 | 332 | 17 | 44.63 | 991.12 | 4.87 | 4.31 | 99,112.00 |
| 37 | Klina | 233 | 705.3 | 229 | 4 | 59.75 | 645.55 | 1.72 | 8.47 | 64,555.00 |
| | TOTALI | 3858 | 10003.666 | 3626 | 232 | 573.39 | 9430.276 | 6.01 | 5.73 | 943,027.60 |

Tabela 18. *Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar - misër sipas komunave*




Figura 18. *Krahasimi i shumës se pagesave për misër për vitin 2012 dhe 2013*

Krahasuar me vitin 2012 sipërfaqet e mbjellura me misë janë rritur për rreth 65% dhe gjithashtu edhe numri i përfituesve dhe shuma totale e pagesës.

Përderisa në vitin 2012 janë paguar 5,754.59 Ha në v. 2013 janë paguar 9,430.27 Ha. Pra, kemi një rritje të sipërfaqeve të mbjellura me misër për 3,675.68 Ha. Fermerët janë subvencionuar me nga 100 €/Ha.

## Luledielli

Bimët vajore janë futur si subvencionim me qëllim të mbështetjes së fermerëve për prodhimin e lëndës së parë për vajrat ushqimore si dhe me qëllim të rritjes së prodhimit dhe përpunimit të këtyre bimëve.

Për subvencionim të sipërfaqeve të mbjellura me luledielli kanë aplikuar gjithsej 31 fermer me një sipërfaqe prej 416.39 Ha, prej të cilëve dy fermer pas kontrollit në terren janë refuzuar pasi që nuk kanë plotësuar kriteret e përcaktuara.

Pas kryerjes së kontrollit në terren dhe procedurave tjera kanë përfituar 29 fermer me një sipërfaqe prej 414.39 Ha ose 41,439.00€.

Krahasuar vitin 2012 me vitin 2013 kemi pasur sipërfaqe më të vogël të mbjellur me luledielli.

| Nr | Komuna | Nr. aplikuesve | Sipërfaqja e aplikuar | Nr. përfituesve | Nr. të refuzuarve | Sipërfaqja e refuzuar | Sipërfaqja e subvencionuar | Pagesa |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Lipjani | 14 | 35.46 | 12 | 2 | 2.00 | 33.46 | 3,346.00 |
| 2 | Podujeva | 1 | 227.52 | 1 | | | 227.52 | 22,752.00 |
| 3 | Graqanica | 9 | 20.27 | 9 | | | 20.27 | 2,027.00 |
| 4 | Ferizaji | 6 | 72.42 | 6 | | | 72.42 | 7,242.00 |
| 5 | Skenderaj | 1 | 60.72 | 1 | | | 60.72 | 6,072.00 |
| | TOTALI | 31 | 416.39 | 29 | 2 | 2.00 | 414.39 | 41,439.00 |

Tabela 19. *Numri i fermerëve përfitues dhe sipërfaqja e subvencionuar për luledielli sipas komunave*

## Lope Qumështore

Pagesat Direkte për krerë të kafshëve - lopë qumështore janë duke vazhduar tash e disa vite dhe nga viti në vit po rritet numri i krerëve të kafshëve dhe pagesa për fermer.

Fermerët përfitues është dashur të plotësojnë kriterin minimal prej 5 krerëve të kafshëve dhe maksimum 50 krerë.

Kontrolli në terren është realizuar në masën mbi 50%.

Janë kontrolluar në masën 100 % të gjithë fermerët që kanë pasur me tepër se 15 krerë lope qumështore, ndërsa fermerët që kanë pasur mes 5 dhe 15 krerë lope qumështore janë kontrolluar

në masën 50%. Të dhënat e paraqitura në aplikim ende nuk janë të sakta, numri i fermerëve të refuzuar është 728 fermer ose 12.55% e fermerëve aplikues.

Nga gjithsej 728 fermer të refuzuar 440 prej tyre janë ndëshkuar për tri vitet e ardhshme për shkak të paraqitjes së të dhënave jo të sakta të cilat dallojnë me tepër se 50% midis sipërfaqes së deklaruar dhe sipërfaqes së verifikuar në terren.

| Nr | Komuna | Nr. aplikuesve | Nr. krerëve ne aplikim | Nr. fermerëve përfitues | Nr. fermerëve te refuzuar | Nr. krerëve te LQ te refuzuar | Nr. krerëve te LQ te subvencionuara | Përqindja e fermerëve te refuzuar | Përqindja e krerëve te LQ te refuzuara | Pagesa(euro) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Prishtina | 206 | 1738 | 175 | 31 | 252 | 1486 | 15.05 | 14.50 | 74,300.00 |
| 2 | Lipjani | 177 | 1526 | 149 | 28 | 202 | 1324 | 15.82 | 13.24 | 66,200.00 |
